

PROÇES-VERBAL TIPI I KONTRATES-SHERBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve dhe automjeteve të Shoqërisë Rajonale U.K. Sarandë”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Automjete**

Loti 1 - “Mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve” - 2 777 950 (dymilion shtateqind e shtatedhjete e shtate mije e nenteqind e pesedhjete)leke pa tvsh

shumatorja e çmimeve për njësi është : 1,789,995 (njemilion e shtateqind e tetedhejte e nente mije e nenteqind e nentedhjete e pese) leke pa Tvsh

Loti 2 “Mirëmbajtje dhe riparim i mjeteve” - 3 173 997 (tre milione e njeqind e shtatedhjete e tremije e nenteqind e nentedhjete e shtate) leke ta Tvsh

shumatorja e çmimeve për njësi është : 1 713 175 (nje milione e shtateqind e trembedhjete mije e njeqind e shtatedhjete e pese) leke pa Tvsh

Loti 3 “Mirëmbajtje dhe riparim i gjeneratoreve” - 829 440 (teteqind e njezete e nente mije e katerqind e dyzete) leke ta Tvsh

shumatorja e çmimeve për njësi është : 531 112 (peseqind e tridhjete e njemije e njeqind e dymbedhjete) leke pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sh.A Sarande ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT(te njejta per Lot-in 1, “Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve” dhe Lot-in 2, ”Mirembajtja dhe riparimi i mjeteve”)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes I vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021 dhe 2022) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 30% të vlerës së përlogaritur të kontratës.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet::

.... 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Kjo procedurë është nën kufirin ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është sa 30% e vlerës së parashikuar të loteve që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2020, 2021 dhe 2022 ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e këtij kriteri, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm në procedurë.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa **20% të vlerës së përlogaritur të lotit që prokurohet (per secilin lot)** dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën 30% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë sa 30 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Licenca profesionale si me poshte:

Kategoria: Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor

Nenkategoria: Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio

Kodi: VII.3.B.1

Lloji i kategorise: Licence, grupi 3

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/b Riparimi dhe mirembajtja e karrocise, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirembajtja e impiantit elektrik, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/d Riparimi dhe mirembajtja e gomave, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

Argumentim: *Kjo kerkese mbeshetet në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, pika 1 a) dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të*

Prokurimit Publik”. nenit 41, pika 4 a) dhe ne ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitim e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar dhe ne udhezimin Nr. 1546, datë 29.3.2016, te Ministrise se Transporteve dhe Infrastruktures.

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për integrimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, Operatori ekonomik duhet te vertetoje nje punesim mesatar te te paktën 4(kater) personave per periudhen Maj-Korrik 2023. Per te vertetuar kete kriter operatorët duhet te paraqese: Vertetim nga Administrata Tatimore per numrin e te siguruarve mujor; Formularet E-SIG 025 ”Listepagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi” te konfirmuara nga administrata tatimore

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Në vendosjen e numrit të punonjësve është bërë një analizë bazuar te faktorët, si kualifikimi i punonjësve, zërat e punëve ,që sic percaktohet edhe ne kategorite e licensimit, jane kater kategori te ndryshme.Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë jep siguri dhe besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën brenda afatit dhe me cilësi.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik, e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, gjithashtu, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 4(kater) persona, është në përputhje me volumin e punës dhe natyrën e punës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë fuqinë punëtore që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.4. Te kete ne sherbim dhe te deklaroje piken (at) e sherbimeve te riparimeve te mjeteve brenda territorit te Bashkise Sarande, ku shtrin aktivitetin Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizimeve Sarande,ose ne territorin e bashkive fqinje me bashkine Sarande, por me kusht qe, pika e servisit te mos jete me shume se 20 km larg nga qyteti i Sarandes, ose te kete kontrate bashkepunimi me nje servis te licensuar qe ploteson kete kusht gjeografik.

Argumentimi: Kjo kerkese mbeshetet ne VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. nenit 41, pika 6):

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Me qellim qe automjeti i defektuar,te mos kryeje distanca te gjata(kur eshte e mundur te vetelevize),per te kryer sherbimin, dhe, ne rastet kur nuk mund te vetelevize,transporti i detyruar i tij, te mos kete kosto te larte dhe humbje kohe, eshte percaktuar distance prej 20 km, si nje distance e pershtatshme per te perfshire ne kete procedure, edhe operatore ekonomike qe kane pika servisesh ne bashkite, Sarande, Konispol,Delvine e Finiq. Nje distance me e madhe se kjo, do te ishte e papershtatshme, sepse do te rriste ne menyre artificiale kostot e sherbimit dhe ne te njejten kohe do te kishim edhe humbje kohe te panevojshme

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT(Lot 3, “Mirembajtja dhe riparimi i gjeneratorëve”)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentim.Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes I vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021 dhe 2022) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 30% të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet::

.... 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence".

Kjo procedurë është nën kufirin ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është sa 30% e vlerës së parashikuar të loteve që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2020, 2021 dhe 2022 ku te paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e këtij kriteri, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm në procedurë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të ligjit nr.25/2018 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 20% të vlerës së përlogaritur të loteve që prokurohen (secili lot) dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën 30% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë sa 30 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Licenca profesionale si me poshte:

Kategoria: Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale te lidhura me transportin rrugor

Nenkategoria: Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio

Kodi: VII.3.B.1

Lloji i kategorise: Licence, grupi 3

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe te motorit, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirembajtja e impiantit elektrik, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

***Argumentim:** Kjo kerkese mbeshtetet në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, pika 1 a) dhe ne VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. neni 41, pika 4 a) dhe ne ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar dhe ne udhezimin Nr. 1546, datë 29.3.2016, te Ministrise se Transporteve dhe Infrastruktures.*

2.3.3. Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për integrimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, Operatori ekonomik duhet te vertetoje nje punesim mesatar i te pakten 2(dy) personash per periudhen Maj-Korrik 2023. Per te vertetuar kete kriter operatorët duhet te paraqese: Vertetim nga Administrata Tatimore per numrin e te siguruarve mujor; Formularet E-SIG 025 "Listepagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi" te konfirmuara nga administrata tatimore

***Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Në vendosjen e numrit të punonjësve është bërë një analizë bazuar te faktorët, si kualifikimi i punonjësve, zërat e punëve ,qe sic percaktohet edhe ne kategorite e licensimit, jane dy kategori te ndryshme.Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë jep siguri dhe besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën brenda afatit dhe me cilësi.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik, e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, gjithashtu, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 2(dy) persona, është në përputhje me volumin e punës dhe natyrën e punës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë fuqinë punëtore që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Specifikimet teknike per proceduren e mirembajtjes se automjeteve

Lot 1

Kompania jone,zoteron keto automjete ,qe do te mirembahen dhe sherbehen sipas kesaj kontratre:



Sprinter 311 Cdi ,Viti 2001,Tipi 903 311, Nr. Shasisë
WDB9036221R333301



Fiat Ducato 2.8 JTD ,viti 2005,Tipi 244CPWN, Nr Shasisë
ZFA24400057749821



Hyundai IX35,Tipi JU81 2.0,Viti 2015,Nr I shasise TMAJU81VDFJ721421



Ford Ranger 2AB,double cab 2.2TDCi,150 HP,Nr I shasise 6FPPXXMJ2PDG35743, Viti 2014



Mitsubishi L200,Viti 2014, Nr Shasise MMCJNKB40FDZ25200 (AA091YP)



Mitsubishi L200,Viti 2014,Nr Shasise MMCJNKB40FDZ25133 (AA092YP)



Mitsubishi L200,Viti 2004, Nr Shasise MMBJNK7404D078290



NISSAN ,Viti 1999,Tipi CGUD22, NrShasise JN1CGUD22U0720721



Fiat Ducato 2.5D,viti 1994,Tipi 230BDMG Nr i Shasise
ZFA23000005147709

Mitsubishi L 200 AA 238 DR(Delvine)

Ford,viti 2008,MNCLS4D107W205091 AA 429 VY (Konispoli)

Sherbimet qe do te kryhen ne keto automjete, jane te percaktuara specifikesht ne preventivin qe shoqeron kete procedure.Ne preventiv,per te orientuar ofertuesit qe, te hartojne sa me sakte oferten, jane paraqitur gjithashtu edhe perqindjet qe, ze secili ze punimesh, ne shumen e te gjithë zerave te punimeve,per njesi dhe per sasi, per cdo automjet dhe perqindjet qe ze vlera e punimeve, per njesi dhe per sasi, te nje automjeti ne shumen totale te te gjithë automjeteve.

P.sh. ne preventiv, tek automjeti Mercedes Sprinter, zeri “ *Motorri dhe sistemet e lubrifikimit dhe ftohjes*”, ze 29% te shumes se punimeve per njesi, per kete automjet dhe 22% te shumes per sasi.Ndersa e gjithë shuma e punimeve per njesi te ketij automjeti ze 16% te shumes se punimeve per njesi per te gjithë automjetet dhe 16% te shumes se punimeve per sasi.Po keshtu per te gjithë zerat e tjere automjetet e tjere qe I perkasin vetem ketij lot-i.

Theksojme se keto jane vlera orientuese;ofertuesi mund te mos I permbahet me rigorozitet ketyre vlerave, mjafton qe oferta e tij te jete ne vlere, brenda vleres limit per cmimin njesi dhe asaj totale, dhe sigurisht, te permbushe te gjitha kerkesat tona per cilesine e punimeve dhe sherbimeve.

Ne preventiv dhe ne keto specifikime teknike, jane paraqitur te gjitha te dhenat e automjeteve, si marka,tipi,viti I prodhimit, nr I shasise, etj,me qellim qe ofertuesi, mbeshtetur ne to,por, edhe ne pervojen e tij, sigurisht, te kete mundesi te gjeje lehtesisht pjesen e kembimit, sasite elloje e lubrifikanteve dhe lengjeve te tjera, qe I nevojiten cdo automjeti, per te llogaritur ne menyre te qarte dhe te sakte, vleren njesi, por, ne nje fare menyre, dhe ate totale te punimeve.

Specifikime teknike per mjetet Lot 2

Mjetet qe zoteron shoqeria jone dhe qe do te mirembahen sipas kesaj procedure jane:



Automjet teknologjik per pastrimin e kanalizimeve te ujrave te ndotura tip Renault D16 MED, Motor DTI 5, Euro 6,176 kW.Ky eshte nje mjet kompleks, qe pervecse eshte nje automjet normal, eshte i pajisur edhe me pajisje dhe sisteme te tjera mekanike, si;

a.Pompe uji e presionit te larte e markes "PRATSSOLI", tipi KS40, 226lit/min, 130 bar,55 kW. *Vaji qe do te perdoret per kete pajisje do te jete cdo lloj vaji hidraulik ISO VG 220 ose ekuivalent*

b.Pompe thithjeje e ujrave te ndotur e markes "Battioni Pagani", tipi KTS 960, 16200lit/min,44 kW. *Vaji qe do te perdoret per kete pajisje do te jete "Battioni Pagani Vacuum Pump oil", "Eni Dicrea 100" ose ekuivalent*

c.Transmision(reduktor) per transmentimin e levizjes ne pompa, i markes "OMSI", tipi PFT-PC4/3000, *Vaji qe do te perdoret per kete pajisje do te jete "Dexron II" ose ekuivalent*

d.Sistem hidraulik per ngritjen e rezervuarit, tubo per presion te larte, tubo per thithjen e mbeturinave, etj,

per te cilet duhet te parashikohen sherbime dhe mirembajtje, prandaj, ofertusi, duhet te kete parasysht qe duhet te jete i afte per te kryer edhe sherbime dhe riparime ne te tilla sisteme.



Skrep,tip Volvo BL61B ,motor DT Volvo D5D CDE3 62 kW,qe perdoret kryesisht nga sektoret e mirembajtjes se rrjetit dhe kanalizimeve te ujrave te ndotur.Per kete mjet, do te kryhen sherbimet preventivuese te parashikuara dhe ndonje riparim i caktuar,sipas preventivit.



Hedhes,shkarkues mbeturinash te ngurta,tip Dumper Silla 1200 SN,motor Lombardini LDW 1204, 21 kW(28,5HP),qe perdoret kryesisht nga sektori i kanalizimeve. Ky mjet ka nevojte qe pervec sherbimeve preventivuese, si nderrime vaji, filtrash,grasatime,etj, te behen edhe disa sherbime ne motor, sipas preventivit.



Skrep Fiat Hitachi FB 120, i cili ne fakt i eshte dhene ne perdorim njesise Finiq, disa vite me pare, dhe tani, sic informohemi, duhet te behen disa riparime per t'a kthyer ne gjendje pune

Lubrifikantet si, vaj per motorat e mjeteve, qe do te perdoren ,do te jene te standartit SAE 10W40 ose 15W40,vaji hidraulik per pajisje hidraulike te paspecifikuara me siper , do te jete ISO VG 32 ose 46 dhe per transmiseone , vaj SAE 75W90 ose 85W90, ose ekuivalente.

Ne preventiv,per te orientuar ofertuesit qe, te hartojne sa me sakte oferten, jane paraqitur gjithashtu edhe perqindjet qe, ze secili ze punimesh, ne shumen e te gjithë zerave te punimeve,per njesi dhe per sasi, per cdo mjet dhe perqindjet qe ze vlera e punimeve, per njesi dhe per sasi, te nje mjete ne shumen totale te te gjithë mjeteve,qe I perkasin ketij lot-i.

Keto jane vlera orientuese;ofertuesi mund te mos I permbahet me rigorozitet ketyre vlerave, mjafton qe oferta e tij te jete ne vlerë, brenda vleres limit per cmimin njesi dhe asaj totale, dhe sigurisht, te permbushë te gjitha kerkesat tona per cilesine e punimeve dhe sherbimeve.

Specifikimet teknike te procedures se mirembajtjes se pajisjeve stacionere si gjeneratore dhe kompresore

Lot 3



Motogjenarotori "TEHNOLINK", me motor IVECO, model N45TM2A, tip F4GE0485A*F650-504241371, 96 kW ,i Stacionit te Pompimit te Ujrave te Ndotur,nr 1, 2,4 dhe 5,Ksamil(3 cope te njejte).Nje gjenerator sherben per stacionet 1 dhe 2, nje per stacionin nr 4 dhe i fundit per stacionin nr 5.



Motogjeneratori "TEHNOLINK" me motor Volvo Penta model TAD1642GE, 565 kW ,i Stacionit te Pompimit te Ujrave te Ndotur nr 6,Ksamil



Motogeneratori tip SDMO, me motor John Deere model 6068HF120, 144 kW, i Stacionit te Pompimit te Ujrave te Ndotura



Kompresori " Bottarini" MSC43 me motor Lombardini LDW 1204

Motosaldatrice Delvine

Pra, per keta motogeneratore emergjence, jane parashikuar te behen kryesisht sherbimet preventivuese, te motorrave te tyre, si sherbimet e nderrimit te vajrave dhe filtrave dhe ndonje sherbim tjetër ne sistemin elektrik apo ate te ushqimit me karburant. Duhet te theksohet se, duke qene se, keta gjeneratore, jane te instaluar neper stacione pompimi, sherbimet e tyre do te kryhen ne vendndodhje, prandaj, ofertuesi duhet t'a kete parasysh kete fakt, kur te hartoje oferten. Me poshte, paraqitet vendodhja (orientuese) e ketyre stacioneve te pompimit ne zonen tone te sherbimit.



Lubrifikantet dhe pjeset e kembimit qe do te perdoren, do te jene ne perputhje me marken , tipin e motorit ose ekuivalente me to.

Ne preventiv,per te orientuar ofertuesit qe, te hartojne sa me sakte oferten, jane paraqitur gjithashtu edhe perqindjet qe, ze secili ze punimesh, ne shumen e te gjithë zerave te punimeve,per njesi dhe per sasi, per cdo gjenerator dhe perqindjet qe ze vlera e punimeve, per njesi dhe per sasi, te nje gjeneratori ne shumen totale te te gjithë gjeneratorëve qe l perkasin ketij lot-i.

Keto jane vlera orientuese; ofertuesi mund te mos l permbahet me rigorozitet ketyre vlerave, mjafton qe oferta e tij te jete ne vlere, brenda vleres limit per cmimin njesi dhe asaj totale, dhe sigurisht, te permbushet te gjitha kerkesat tona per cilesine e punimeve dhe sherbimeve.

Sherbimet dhe riparimet, do te kryhen , sic thame me siper, ne vendin ku ndodhen gjeneratoret, nen mbikeqyrjen e nje perfaqesuesi te U.K.Sarande dhe per cdo sherbim do te mbahet nje dokumentacion perkates.

Detajet e procesit te kryerjes se sherbimit te mirembajtjes dhe riparimit per te treja dhe plotesimit te dokumentacionit, jepen me poshte :

1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë, pranë autoritetit kontraktor pjesët e zëvendësuar të automjeteve, brenda afatit te riparimit, qe percaktohet me poshte.
2. Operatori ekonomik duhet te garantoje ruajtjen dhe sigurimin e mjeteve gjate procesit te riparimit deri ne dorëzimin e tyre. Operatori ekonomik mban pergjegjesi per demtimin duke e zhdemtuar AK ne vleren e demit te shkaktuar, gjate kohes qe e ka marr ne dorezim sipas objektit te prokurimit. Operatori ekonomik mban pergjegjesi per vjedhjen apo humbjen e mjetit, gjate kohes qe e ka marr ne dorezim sipas objektit te prokurimit, sipas vleres te kontabilizuar te mjetit. Operatori ekonomik mban pergjegjesi per cdo demtim te mundshem, ndaj AK apo te treteve, gjate transportit te mjeteve drejt servisit apo gjate transportit te mjeteve kur del nga servisi, gjate kohes qe e ka marr ne dorezim sipas objektit te prokurimit.
3. Riparimi duhet te filloje brenda dites se punes(kur ka kohe) ose ditën e nesërme te paraqitjes se automjetit per riparim.Koha e riparimit do te percaktohet ne raportin teknik , ne varesi te defektit, por jo me shume se 2 dite per defekte motorike,xhenerike, elektrike, dhe jo me shume se 3 dite per riparime karrocierie.
4. Dokumentacioni qe do te shoqeroje nje punim do te jete i perbere nga;
 - Akti i konstatimit te defektit - A.K.
 - Proces verbali i dorezimit te mjetit/automjetit ne servis – i perbashket
 - Raporti teknik i verifikimit te defektit dhe natyra e punimeve qe do te kryhen - O.E.
 - Preventivi i punimeve - O.E
 - Situacioni i punimeve - O.E
 - Proces verbali i marrjes ne dorezim pas riparimit – I perbashket
 - Certifikata e garancise se punimeve - O.E.
5. Në cmimin e ofertuar për çdo material, pjesë këmbimi apo sherbim, etj., te përfshihet edhe kosto e punës për kryerjen e shërbimit (heqje/vendosje e materialit, pjesës së këmbimit, etj.), te gjitha taksat, tatimet dhe shpenzime te tjera, me përjashtim të TVSH.

6. Në rast të përsëritjes së të njëjtit difekt, apo shkaktimit të difekteve të reja, brenda afatit të garancisë që mund të kenë rrjedhur si pasojë e këtij difekti të riparuar me mangësi, shërbimet do të kryhen nga operatori ekonomik, me shpenzimet e tij, duke përfshirë edhe transportin e automjetit, kur ai për shkak të këtij difekti, ngelet në rrugë. (Në rastin e gjeneratorëve është e kuptueshme që nuk bëhet fjalë për transport të tyre)
7. Në rast se automjeti pëson difekt në rrugë, por jo për shkak të punimeve të kryera me pare nga O.E., ky i fundit, sidoqoftë, duhet të marrë masë për riparimin e difektit në rrugë, kur kjo është e mundur ose për transportimin e mjetit në pikën e tij të servisit, kur difekti është me i rëndë, sigurisht kundrejt pagesës
8. Garancia për shërbimet e kryera, si dhe për pjesët e këmbimit të jetë jo më pak se 12 muaj.

Shpërndarja: Vendi i kryerjes së shërbimeve: Servisi i Operatorit Ekonomik me të cilin do të lidhet Marrëveshja Kuadër, për secilin LOT.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga një specialist fushë, inxhinier mekanik, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nëpërmjet kësaj kontrate, synohet të realizohet mirëmbajtja dhe riparimi e automjeteve, mjeteve të rënda dhe mjeteve stacionare, që shoqëria jone disponon.

Në specifikimet teknike është dhënë informacioni i nevojshëm për secilin mjet si; marka, tipi, viti i prodhimit, nr. shasisë, vendndodhja e mjeteve stacionare, llojet e lubrifikanteve për agregatet speciale, raportin që zënë zerrat e ndryshëm të punimeve, etj, me qëllim që operatori ekonomik, të ketë informacionin e duhur për të hartuar sa më sakte kontratën

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje dhe riparim I mjeteve dhe automjeteve të shoqërisë”

NJËSIA E PROKURIMIT

ANILA VJERI

ALTIN MACI

ENDRIN LLANAJ